



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.06.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Berisha Com” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Intervenime emergjente”, me Nr. të Prok: 632-21-1635-5-2-1, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik “Berisha Com” SH.P.K., e dt. 07.06.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Intervenime emergjente”, me Nr. të Prok: 632-21-1635-5-2-1, kundër NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, te AK –së, të datës 02.06.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. Vërtetohet NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES të publikuar me datë: 02.06.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “Berisha Com” SH.P.K. me datë 07.06.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Intervenime emergjente”, me Nr. të Prok: 632-21-1635-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.06.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas rishikimit të dokumenteve, Autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupi Operatorëve Ekonomik N.P.SH."Eltoni Com" & N.T.SH."Marash - Shped" & "Company Zuka Commerce" sh.p.k, i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara në dosjen e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Tenderi juaj është eliminuar për arsye se nuk plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës